



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsu, 60000, Gjiilan, Kosovë

www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: KRIMINOLOGJI ME PENOLOGJI

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	KRIMINOLOGJI ME PENOLOGJI
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	2019/2020-viti i IV-të, semestri i VII-të
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6/ECTS
Koha / lokacioni:	Ligjëratat: E premte (ora:10:30 deri 12:00), Asistent: Dr. Sc. Fatmire Krasniqi
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Sc. Feti Limani, Prof. Ass.
Detajet kontaktuese:	fetilimani@hotmail.com
Përshkrimi dhe qëllimi i studimit të lëndës:	Përgatitja dhe aftësimi i juristëve të ardhshëm, e sidomos të atyre që punojnë në organet e judikaturës penale (polici, prokurori, gjykata, burgjet, qendrat e paraburgimit, institucionet edukativo-korrektuese, spitalet e burgjeve etj., si dhe në organet e tjera që merren me këtë problematikë), që të përdorin me sukses njohuritë e fituara të fushës kriminologjike dhe penologjike që kanë të bëjnë me format dhe shkaqet e paraqitjes së kriminalitetit dhe me zbatimin e mjeteve dhe metodave bashkëkohore në procesin e risocializimit të personave të dënuar dhe parandalimin e suksesshëm të kriminalitetit në përgjithësi.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që: - Të jetë i kompletuar me njohurit themelore të lëndës së Kriminologjisë me Penologji dhe t'i zbatojë ato në jetën praktike; - Të përcjellë dhe krahasojë rezultatet e arritura shkencore në fushën e Kriminologjisë me Penologji dhe të përdorë këto rezultate në procesin e luftimit dhe parandalimit të kriminalitetit; - Të kuptojë dhe përshkruaj me sukses nocionet themelore që kanë të bëjnë me format, shkaqet dhe parandalimin e kriminalitetit si dhe me mjetet e metodat në procesin e risocializimit të personave të dënuar; - Të zbatojë njohuritë dhe rezultatet e shkencës së Kriminologjisë me Penologji në praktikën e luftimit dhe parandalimit të suksesshëm të kriminaliteti

Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2		2
Ushtrime teorike/laboratorike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2		2
Kollokfiume,seminare	1		1
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2		2
Përgatitja përfundimtare për provim	2		2
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1		1
Projektet, seminare, prezantimet ,etj			
Totali	10		10
Metodologjia e mësimdhënies:	- Ligjërata interaktive: Në pjesën më të madhe të kohës do të organizohen ligjërata interaktive që d.m.th. se përveç ligjërimit nga ana e mësimdhënësit, kyçen edhe studentët, qoftë duke pyetur apo edhe duke diskutuar dhe këmbyer mendimet e tyre lidhur me çështjet tematike që janë objekt i ligjërates. - Punimet seminarike: Studentët do të kenë mundësi të përcaktohen për ndonjë temë apo punim seminarik, ku para fillimit të punës së tyre, atyre u ofrohen udhëzimet elementare lidhur me hartimin e punimeve të tilla, dhe pas përfundimit të tyre ata kanë mundësi të prezantimit para studentëve të tjerë të rezultateve të punimeve të këtyre, ku edhe do të zhvillohet debati lidhur me temat e trajtuara. - Ndarja në grupe të vogla të studentëve: Do të bëhet përpjekje në aplikimin e punës grupore me studentë, ku ata ndahen në grupe të vogla me qëllim të debatimit dhe kyçje së këtyre grupeve në trajtimin e temave të ndryshme që do të jenë objekt i ligjërimit. - Vizitat në institucionet korrektuese: Si pjesë e punës praktike me studentë do të jetë edhe organizimi i vizitave në ndonjë institucion korrektues të Kosovës apo jashtë saj, ku studentët do të njihen me praktikën e ekzekutimit të dënimeve dhe trajtimin e të dënuarve. - Zbatimi i metodave bashkëkohore të ligjërimit: Gjatë punës		

	me studentë do të përdoren metoda dhe teknika të ndryshme dhe bashkëkohore të ligjërimit të cilat do të jenë në funksion të shpjegimit të problemeve themelore kriminologjike dhe penologjike në mënyrë që studentët të kenë mundësi të kyçen pa probleme në nxënien dhe përvetësimin e materies që është objekt trajtimi.
Metodat e vlerësimit:	Studentët i nënshtrohen vlerësimit përgjatë gjithë semestrit. Testi gjysmësemestral dhe ai final mbahen me shkrim. Në vlerësimin përfundimtar përfshihet edhe pjesëmarrja aktive në orën mësimore dhe detyrat e shtëpisë. - Testi gjysmësemestral 30% - Testi final 50% - Aktiviteti në orë (seminar, ese, detyre shtëpie, etj) 15% - Pjesëmarrja 5% Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90 = 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50, nuk mbërrijnë/përmbyllin notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016 dhe 2011; Dr. Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2016;
Literatura shtesë:	Dr. sc. Rexhep Gashi, Krimi i organizuar Prishtinë, 2014; Dr. sc. Rexhep Gashi, Krimi i jakës së bardhë, Prishtinë, 2012; Dr. sc. Rexhep Gashi, Ekzekutimi i dënimeve alternative, Prishtinë, 2013; Dr. sc. Rexhep Gashi, Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë, 2001; Ligji nr.04/L-149 Për ekzekutimin e sanksioneve penale, Prishtinë, 2013; Kodi nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur, Prishtinë, 2010.
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	- Kuptimi i shkencës së Kriminologjisë;

	- Lënda (objekti) i Kriminologjisë - Evidencat statistikore mbi kriminalitetin; - Llojet e evidencave statistikore mbi kriminalitetin; Literatura: Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq.9-11; 20-32 dhe 50-60.
Java e dytë:	- Kuptimi i Fenomenologjisë kriminale; - Vëllimi dhe struktura e kriminalitetit; - Format e manifestimit të kriminalitetit; - Kriminaliteti profesional dhe veçoritë themelore të tij; - Kriminaliteti i “Jakës së bardhë”. - Kuptimi dhe veçoritë kryesore të kriminalitetit të organizuar Literatura: Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq.115-126; 135-143; Dr. sc.Rexhep Gashi, Krimi i organizuar, Prishtinë, 2014; Dr.sc.Rexhep Gashi, Krimi i jakës së bardhë, Prishtinë, 2012.
Java e tretë:	- Kriminaliteti politik; - Terrorizmi politik; - Kriminaliteti kundër lirive dhe të drejtave të njeriut; - Krimet kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare. - Kriminaliteti i dhunës; - Kriminaliteti seksual apo dhuna seksuale; - Kriminaliteti ekonomik. Literatura: Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq.161-205.
Java e katërt:	- Kriminaliteti kundër pasurisë; - Kriminaliteti kompjuterik ose me kompjuter; - Kriminaliteti kundër ambientit ose ekologjik; - Kriminaliteti në trafik –komunikacion; - Delikuenca e të miturve; - Recidivizmi (përsëritja e sjelljeve kriminale). Literatura: Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq. 205-235.

Java e pestë:	- Kuptimi dhe roli i faktorëve kriminogjen (etiologjisë kriminale); - Faktorët e jashtëm (objektivë) të kriminalitetit; - Kuptimi dhe ndarja e faktorëve objektivë; - Faktorët ekonomiko-shoqërorë. Literatura: Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq. 235-236; 241-253.
Java e gjashtë:	- Faktorët ideo-politikë të kriminalitetit; - Konfliktet politike dhe kriminaliteti; - Konfliktet kulturore dhe kriminaliteti; - Lufta dhe kriminaliteti; - Arsimiti dhe kriminaliteti; - Mjetet e komunikimit; - Masmedia dhe kriminaliteti; - Religjioni dhe sektet ekstreme si faktorë kriminogjenë. - Faktorët mikrogruporë të kriminalitetit; - Familja si faktorë kriminogjenë; - Shkolla dhe ambienti shkollorë si faktorë kriminogjenë; - Mjedi shoqërorë – ambienti social si faktorë kriminogjenë; Literatura: Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq.253-288.
Java e shtatë:	- Faktorët sociopatologjik të kriminalitetit; - Prostitucioni dhe kriminaliteti; - Patologjia seksuale dhe kriminaliteti. - Alkoolizmi dhe kriminaliteti; - Narkomania dhe kriminaliteti; - Bixhozi dhe kriminaliteti; - Bredhja, lëmosha dhe kriminaliteti; - Dukuria e AIDS-it dhe kriminaliteti; - Dukuria e vetëvrasjeve; - Hakmarrja dhe gjakmarrja. Literatura:

	Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq.288-336.
Java e tetë:	- Faktorët e brendshëm (subjektivë) të kriminalitetit; - Vetitë dhe baza psikike e personalitetit dhe kriminaliteti; - Çrregullimet mentale dhe kriminaliteti; - Neuroza dhe kriminaliteti - Psikopatit dhe kriminaliteti - Psikozat dhe kriminaliteti - Vlerësimi i parë intermedial (ora e dytë). Literatura: Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq.339-340; 362-381.
Java e nëntë:	- Kuptimi i Penologjisë (shkencës mbi ekzekutimin e sanksioneve penale); - Lënda e Penologjisë; - Metodatat e Penologjisë; - Raporti i Penologjisë me shkencat e tjera. Literatura: Dr. Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2016, fq.15-27.
Java e dhjetë:	- Karakteri dhe llojet e sanksioneve penale para paraqitjes së dënimit me burgim; - Llojet e dënimeve para paraqitjes së dënimeve me burgim; - Dënimet me burgim dhe ekzekutimi i tyre; - Paraqitja e dënimeve me burgim dhe burgjet e para; - Format e dënimeve me burgim dhe transformimi i tyre; Literatura: Dr. Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2016, fq.85 - 102; Dr. Rexhep Gashi, Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë, 2001, fq.9-27.
Java e njëmbdhjetë:	- Sistemet kryesore të ekzekutimit të dënimeve me burgim; - Kuptimi dhe llojet; - Sistemi i burgut kolektiv; - Sistemi i izolimit apo i qelisë; - Sistemi i heshtjes ose o Obërnit;

	- Sistemi progresiv; - Sistemi i klasifikimit ose i Gjenevës; - Sistemi modern ose bashkëkohorë. - Ekzekutimi i dënimeve me burgim dhe tretmani i të burgosurve; - Procesi i riedukimit dhe riintegrit; Literatura: Dr. Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2016, fq.103-123; 145-148; Dr. Rexhep Gashi, Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë, 2001, fq.9-27; Ligji nr.04/L-149 Për ekzekutimin e sanksioneve penale, Prishtinë, 2013.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	- Trajtimi i të dënuarve si kusht për riintegrimin e tyre; - Individualizimi i trajtimit të personave të dënuar; - Observimi dhe studimi i të dënuarve. - Klasifikimi i personave të dënuar; - Klasifikimi dhe kategorizimi i institucioneve korrektuese; Literatura: Dr. Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2016, fq.148-170; Dr. Rexhep Gashi, Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë, 2001, fq. 173-229; Ligji nr.04/L-149 Për ekzekutimin e sanksioneve penale, Prishtinë, 2013.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	- Mjetet dhe metodat e tretmanit të personave të dënuar; - Kuptimi, rëndësia dhe llojet e tyre; - Puna e personave të dënuar; - Puna e personelit penitenciar me personat e dënuar; - Metodatat e tretmanit grupor me personat e dënuar; - Vetëorganizimi i personave të dënuar; - Arsimimi dhe ngritja profesionale e personave të dënuar; - Aktivitetet kulturore, zbavitëse dhe sportive me të dënuar. - Organizimi dhe struktura e organeve dhe shërbimeve kryesore në institucione korrektuese; - Struktura dhe organizimi i brendshëm i institucioneve

	korrektuese. Literatura: Dr. Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2016, fq. 171-205; Dr.Rexhep Gashi, Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë, 2001, fq.229-279 Ligji nr.04/L-149 Për ekzekutimin e sanksioneve penale, Prishtinë, 2013.
Java e katërbëdhjetë:	- Pozita e personave të dënuar gjatë qëndrimit në institucionet korrektuese; - Fillimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe burgim afatgjatë; - Shtyrja e fillimit të ekzekutimit të dënimit me burgim; - Pranimi i personave të dënuar në institucione; - Vendosja, ushqimi dhe veshëmbathja e të dënuarve; - Të drejtat dhe benificionet e personave të dënuar gjatë qëndrimi institucionet korrektuese; - Detyrimet e personave të dënuar; - Ruajtja e rendit dhe disiplinës në institucionet korrektuese; - Transferimi, pezullimi dhe lëshimi në liri i personave të dënuar; - Lirimi me kusht i të dënuarve; - Ekzekutimi i dënimeve alternative; - Ekzekutimi i sanksioneve penale ndaj të miturve; - Ekzekutimi i masave edukative ndaj të miturve; - Ekzekutimi i dënimeve ndaj të miturve; Literatura: Dr. Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2016, fq.213-235; 255-271; Dr.Rexhep Gashi, Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë, 2001, fq.307- 341; Dr.sc.Rexhep Gashi, Ekzekutimi i dënimeve alternative, Prishtinë, 2013; Ligji nr.04/L-149 Për ekzekutimin e sanksioneve penale, Prishtinë, 2013; Kodi nr.03/L-193 i 7 Drejtësisë për të Mitur, Prishtinë, 2010.
Java e pesëmbëdhjetë:	- Vlerësimi i dytë intermediar

--	--

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
- Fillimi dhe përfundimi i orës mësimore në pajtim me orarin dhe informatën për studentë; - Mos përdorimi i telefonit mobil gjatë ligjeratës; - Mospirja e duhanit; - Moskonsumimi pijeve dhe ushqimeve të ndryshme; - Mos të kopjojnë gjatë provimit dhe testimeve të tjera; - Komunikimi civilizues dhe dinjitoz me studentë; - Sigurimi i qetësisë dhe disiplinës gjatë orës së mësimit si dhe - Të dëgjojnë me kujdes si mësimdhënësin ashtu edhe kolegët e tyre.